



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Milena Đerić, Faton Ademi, Burim Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja, me seli në Prishtinë dhe për apelin e Organizatës joqeveritare “GERMIN”, me seli në Prishtinë, Rruga “Tringë Smajli”, Nr. 48, të paraqitura kundër vendimit nr. 42-2021 i datës 11.01.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 13.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhen të palejuara apelet Anr.1/2021 i datës 12.01.2021, i ushtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja dhe Anr.2/2021 i datës 12.01.2021, i ushtruar nga Organizata joqeveritare “GERMIN”, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me nr. 42-2021 i datës 11.01.2021, që ka të bëjë me Verifikimin e Aplikacioneve për Regjistrim për Periudhën e Aplikimit për Regjistrim të Votuesve Jashtë Kosove.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 12.01.2021, ka pranuar apelet: Anr.1/2021 i ushtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosja dhe apelin Anr.2/2021, i ushtruar nga Organizata joqeveritare “GERMIN”, të cilat apele janë paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me Nr. 42-2021 i datës 11.01.2021, në të cilat pretendohet se KQZ-ja, me rastin e marrjes së vendimit të apeluar konkretisht pika 4, e vendimit të lartcekur, përcakton se “Nëse aplikuesi nuk lajmërohet në telefon, atëherë aplikacioni i tij refuzohet”. Sipas parashtruesve të apeleve, kjo mënyrë e verifikimit të aplikuesve nuk është kriter ligjor dhe vështirëson në masë të madhe procedurat ligjore deri te arritja e fletëvotimeve në Kosovë. Ky kriter shtesë nuk është në përputhje me nenin 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), lidhur me nenet 22, 45, 53, 55 të Kushtetues së Republikës së Kosovës, konkretisht me të drejtën aktive të zgjedhjes, e të cilat kritere janë kundër kushtetuese dhe kundërligjore. Si të tilla nuk duhet të merren parasysh sepse cenojnë liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve të

Republikës së Kosovës. Me propozim për panelin, që apelet të pranohen si të bazuara dhe të anulohet vendimi i apeluar.

KQZ-ja, përmes përgjigjeve në apele, ka theksuar se me vendimin e apeluar nuk është bërë përfshirja ose largimi i një personi për të marrë pjesë në programin për votim brenda dhe jashtë Kosovës, në kuptim të nenit 122 paragrafi 1 i LZP-së, siç pretendojnë apeluesit. Me propozim për panelin, që apelet të hedhen si të palejuara.

Paneli, në kuptim të nenit 3 paragrafi 8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesën Anr.2/2021 e datës 12.01.2021, vendosi ta trajtojë si apel, duke e vlerësuar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat, ndërsa në bazë të nenit 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, paneli më qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar apelet Anr.1/2021 dhe Anr.2/2021 të datës 12.01.2021, dhe janë trajtuar si një apel, andaj procedimi i këtyre apeleve tani e tutje evidentohen, me shenjë e përbashkët Anr.1/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të apeluesve.

Paneli, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apeleve, gjeti se:

Apelet janë të palejueshme

Me nenin 63 paragrafi 3 i LZP-së, përcaktohet se: *“Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj”.*

Me nenin 64 paragrafi 2 pika a) i LZP-së, përcaktohet se: *“KQZ-ja i përgatitë dhe shpall rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj”*, ndërsa me pikën b) të këtij neni përcaktohet se: *“KQZ-ja, i publikon të gjitha rregullat e miratuara, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bënë ato të arritshme për opinionin”.*

Apelimet zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- **a)** *Përfshirjen ose largimin e një personi për të marrë pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;*
- **b)** *Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;*
- **c)** *Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*
- **d)** *akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;*
- **e)** *vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe*
- **f)** *Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.*

Nga interpretimi i dispozitave të lartcekura rezulton se vendimet e KQZ-së, nuk janë të apelueshme përveç nëse parashihen qartë më ligj. Në këtë rast vendimi i apeluar i KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelohehen e të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b) c), d), e) dhe f), për arsye se vendimi i apeluar hynë në kategorinë e vendimeve të karakterit teknik

menaxhues të KQZ-së, e i cili vendim është nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 64 të LZP-së, e i cili vendim nuk prek apo cenon një të drejtë themelore të votuesve.

Meqenëse vendimi i apeluar siç u cek më lartë hynë në kuadër të vendimeve teknike organizative, Paneli nuk u lëshua në vlerësimin merititor të çështjes, pasi vlerësoi se ky vendim nuk mund të apelohej për arsyet e cekura më lartë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1/2021 datë 13.01.2021

Kryesues i Panelit
Krustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 4 i LZP-së,